

Tiranë 6.07.2026

SHKRESË PËRCJELLËSE

- LËNDA:** Kërkesë për përshpejtimin e rigjyimit të çështjes, si dhe përcjellje e parashtrimeve në Gjykatën e Lartë për rishqyrtimin e çështjes, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
- DREJTUAR:** Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, Kolegjit Penal.
- DËRGUES:** Erion Veliaj, përfaqësuar nga Av. Plarent Ndreca.

Të nderuar,

Bashkëlidhur paraqesim parashtrimet tona për rishqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese me të cilin është shfuqizuar vendimi nr. 00-2025-1153 (176), datë 08.07.2025, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe çështja është dërguar për rishqyrtim pranë Gjykatës së Lartë.

Kjo shkresë ka dy qëllime procedurale të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën: së pari, të përcjellë në mënyrë formale parashtrimet e mbrojtjes mbi standardin që duhet të zbatohet në rigjykim; së dyti, të kërkojë që rishqyrtimi i çështjes të trajtohet me përparësi dhe, në përfundim të tij, Gjykata e Lartë ta zgjidhë vetë çështjen, pa e kthyer atë për rishqyrtim në shkallët më të ulëta, për sa kohë që zbatimi i ligjit procedural dhe material nuk kërkon rivlerësim faktesh apo provash.

I. Nevoja për përshpejtimin e rigjyimit

Kërkesa për përshpejtim nuk mbështetet në një interes abstrakt për shqyrtim të shpejtë, por në pasoja konkrete dhe të përditshme mbi lirinë personale, mbi ushtrimin e mandatit të fituar me votë dhe mbi funksionimin e qeverisjes vendore në Bashkinë e Tiranës.

Z. Erion Veliaj e ka marrë zyrtarisht mandatin e tretë si Kryetar i Bashkisë së Tiranës në qershor 2023. Ky mandat përfundon në qershor 2027. Në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë, ka kaluar më shumë se gjysma e mandatit dhe mbetet më pak se një vit deri në përfundimin e tij. Çdo vonesë në rigjykim nuk është, për rrjedhojë, thjesht vonesë procedurale; ajo konsumon vetë kohën e mandatit dhe e bën gjithnjë e më të pakthyeshme pasojën që masa e sigurimit ka prodhuar mbi ushtrimin e

funksionit publik, si dhe të pazbatueshëm efektivisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, edhe një vendim eventualisht pozitiv i Gjykatës së Lartë, nëse jepet pasi koha reale e mandatit të jetë konsumuar në mënyrë të konsiderueshme ose pranë përfundimit, do të rrezikonte të mbetet pa efekt praktik, pasi nuk do të mund të rikthente në mënyrë reale periudhën e humbur të ushtrimit të mandatit, as të riparonte pasojën institucionale të krijuar nga pamundësimi faktik i funksionit të Kryetarit të Bashkisë dhe as cenimin e së drejtës së qytetarëve dhe zgjedhësve për t'u qeverisur nga përfaqësuesi i zgjedhur prej tyre.

Mandati i të zgjedhurit vendor është për një periudhë të kufizuar dhe të pakthyeshme kohe. Në rastin konkret, ai përbëhet nga 48 muaj, nga qershori 2023 deri në qershor 2027. Çdo muaj vonesë në rishqyrtim nuk mund të kompensohet më vonë, sepse nuk mund t'i kthehet as z. Veliaj dhe as zgjedhësve të Bashkisë së Tiranës koha e humbur e ushtrimit efektiv të mandatit. Për këtë arsye, urgjenca nuk buron nga statusi personal i rekursuesit, por nga vetë natyra e mandatit të zgjedhur dhe nga detyrimi i gjykatës për të garantuar një mjet juridik efektiv, jo vetëm një vendim të vonuar.

Nëse çështja nuk shqyrtohet me përparësi, rigjykimi rrezikon të humbasë efektivitetin e tij praktik. Një vendim i dhënë vonë, kur periudha reale e mandatit është konsumuar në pjesën më të madhe ose tërësisht, nuk do të rivendoste dot në mënyrë efektive të drejtën për të ushtruar funksionin publik, as do të riparonte pasojën institucionale që ka sjellë pamundësimi faktik i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për të ushtruar detyrën. Për këtë arsye, elementi kohor në këtë çështje është pjesë e vetë substancës kushtetuese të saj. Liria personale, e drejta për t'u zgjedhur, ushtrimi real i mandatit dhe e drejta e zgjedhësve për t'u qeverisur nga organi që kanë zgjedhur me votë, nuk mund të mbrohen në mënyrë efektive nëse rishqyrtimi vonohet deri në atë pikë sa rezultati i tij të mbetet vetëm deklarativ.

II. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese kërkon rigjykim efektiv, jo përsëritje formale të procedurës

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk e ka kthyer çështjen për një verifikim formal të arsyetimit të mëparshëm. Ai ka identifikuar mungesë kontrolli efektiv nga Gjykata e Lartë mbi pretendime që prekin substancën e lirisë personale, proporcionalitetin e masës 'arrest në burg', efektin e saj mbi mandatin e zgjedhur, dinjitetin njerëzor, prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjen efektive.

Kjo do të thotë se rishqyrtimi duhet të jetë real, aktual dhe i lidhur me gjendjen juridike e faktike në momentin kur Gjykata e Lartë vendos. Në këtë moment, çështja nuk ndodhet më në të njëjtën situatë si në kohën e vendimit të shfuqizuar: masa ka vijuar edhe më gjatë, pasojat mbi mandatin janë bërë më të rënda, ndërsa vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka sqaruar detyrimin e Gjykatës së Lartë për t'u dhënë përgjigje substanciale pretendimeve të mbrojtjes. Pikërisht për këtë arsye, përsheptimi i rigjykimit është i domosdoshëm. Ai nuk kërkohet për të shmangur shqyrtimin e plotë të çështjes, por për të garantuar që ky shqyrtim të jetë efektiv dhe të mos zbrazet nga kuptimi për shkak të kalimit të kohës.

III. Gjykata e Lartë duhet ta zgjidhë përfundimisht çështjen, duke shqyrtuar në substancë cenimet e konstatuara dhe të pretenduara

Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ndodhet përpara një çështjeje që nuk kërkon kthim formal në shkallët më të ulëta, por kërkon ushtrimin e plotë të juridiksionit të saj për të dhënë një zgjidhje përfundimtare. Kjo sepse thelbi i rishqyrtimit nuk lidhet me nevojën për marrjen e provave të reja, me dëgjimin e dëshmitarëve, me rivlerësimin e besueshmërisë së provave apo me rindërtimin e fakteve të çështjes në themel. Çështja që shtrohet përpara Gjykatës së Lartë është, në thelb, juridike dhe kushtetuese: nëse masa e sigurimit “arrest në burg”, ashtu siç është vendosur, lënë në fuqi dhe lejuar të vijojë në kohë, përmbush standardin e domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe arsytimit konkret; si dhe nëse mbajtja e z. Veliaj në kabinën/kafazin e xhamit gjatë seancave gjyqësore është e pajtueshme me dinjitetin njerëzor dhe prezumimin e pafajësisë.

Pikërisht për këtë arsye, në këtë rast plotësohen kushtet e nenit 441, germa dh), të Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë i njeh Gjykatës së Lartë kompetencën që të vendosë ndryshimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe ta zgjidhë përfundimisht çështjen, kur zbatimi i ligjit procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave. Në rastin konkret, ajo që kërkohet nuk është një hetim i ri gjyqësor mbi faktet, por kontrolli nëse vendimet e mëparshme i kanë dhënë përgjigje reale dhe substanciale pretendimeve që prekin lirinë personale, mandatin e zgjedhur, dinjitetin njerëzor dhe garancitë e procesit të rregullt.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka bërë të qartë se problemi nuk qëndron te mungesa e një hallke tjetër procedurale, por te mungesa e kontrollit efektiv nga Gjykata e Lartë mbi pretendimet thelbësore të ngritura nga mbrojtja. Për rrjedhojë, detyra e rishqyrtimit nuk mund të përmbushet përmes një kthimi mekanik të çështjes në gjykatat më të ulëta. Ajo kërkon që vetë Gjykata e Lartë të shqyrtojë në substancë nëse arresti në burg është ende i domosdoshëm, nëse rreziqet procedurale janë individualizuar realisht, nëse masat alternative janë analizuar seriozisht, nëse barra e justifikimit është mbajtur nga organi i akuzës dhe nëse pasoja e masës mbi mandatin e zgjedhur është peshuar në mënyrë të vërtetë.

Në këtë vlerësim, Gjykata e Lartë nuk mund të kufizohet në pyetjen nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm apo nëse masa është vendosur më parë nga gjykatat e posaçme. Standardi kushtetues dhe konventor kërkon më shumë. Ai kërkon që vijimi i privimit nga liria të mbështetet mbi arsye konkrete, aktuale, të rëndësishme dhe të mjaftueshme. Masa “arrest në burg” është masa më e rëndë e sigurimit personal dhe, për këtë arsye, mund të qëndrojë në fuqi vetëm nëse gjykata tregon pse asnjë masë tjetër më pak kufizuese nuk është e aftë të garantojë qëllimet e procedimit penal. Në mungesë të këtij arsytimi, masa nuk është më instrument procedural i domosdoshëm, por shndërrohet në kufizim joproporcional të lirisë personale.

Ky përfundim bëhet edhe më i fortë për shkak të efektit që masa ka prodhuar mbi mandatin e z. Veliaj si Kryetar i Bashkisë së Tiranës. Mandati i tretë është marrë zyrtarisht në qershor 2023 dhe përfundon në qershor 2027. Ky është një mandat me kohë të kufizuar dhe të pakthyeshme. Çdo muaj i kaluar nën një masë që e bën praktikisht të pamundur ushtrimin e funksionit publik nuk është vetëm kufizim i lirisë personale të rekursuesit, por edhe konsumim faktik i mandatis të dhënë nga zgjedhësit. Për këtë arsye, proporcionaliteti nuk mund të analizohet vetëm në raportin individ-shtet, por edhe në

raport me pasojën institucionale që masa prodhon mbi qeverisjen vendore dhe mbi të drejtën e zgjedhësve për t'u qeverisur nga përfaqësuesi i zgjedhur prej tyre.

Në këtë kuptim, kthimi i çështjes në shkallët më të ulëta do të krijonte një cikël të ri procedural, i cili do të zgjaste edhe më shumë një gjendje që tashmë ka pasoja të rënda dhe potencialisht të pariparueshme. Nëse Gjykata e Lartë do ta kthente çështjen për rishqyrtim, vendimmarrja për masën do të rrezikonte të humbiste çdo efekt praktik mbi mandatin qershor 2023 - qershor 2027. Një vendim i dhënë pasi mandati të jetë konsumuar në pjesën më të madhe, ose tërësisht, nuk do të mund të rivendoste në mënyrë efektive të drejtën e cenuar. Ai do të mbetet një konstatim i vonuar, jo një mjet real mbrojtjeje.

E njëjta logjikë vlen edhe për pretendimin lidhur me mbajtjen e z. Veliaj në kabinën/kafazin e xhamit. Edhe ky pretendim nuk kërkon rivlerësim faktesh apo provash në kuptimin e nenit 441, germa dh), të KPP-së. Ai kërkon një vlerësim juridik dhe kushtetues mbi faktin nëse izolimi i një të pandehuri në një kabinë/kafaz xhami, pa identifikim konkret të një rreziku real dhe aktual, pa arsytim individual dhe pa shqyrtim të masave më pak kufizuese, është i pajtueshëm me dinjitetin njerëzor, dhe prezumimin e pafajësisë. Kjo është çështje standardi, jo çështje prove të re.

Qëndrimi në kafaz xhami nuk mund të trajtohet si çështje infrastrukture gjykatore ose si praktikë rutinore organizimi salle. Ai ka një domethënie të drejtpërdrejtë kushtetuese. Vendosija e një personi të prezumuar të pafajshëm në një hapësirë të izoluar, të dukshme për publikun, mediat dhe trupin gjykues, krijon imazhin e rrezikshmërisë dhe fajësisë përpara se fajësia të jetë provuar. Për më tepër, nëse kjo masë pengon ose vështirëson komunikimin konfidencial dhe efektiv me mbrojtjen, ajo nuk cenon vetëm dinjitetin, por edhe vetë cilësinë e pjesëmarrjes së të pandehurit në proces.

Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë duhet të shqyrtojë në substancë nëse ekzistonte ndonjë arsye konkrete, e shqyrtuar dhe analizuar nga gjykatat e zakonshme, që e bënte të domosdoshëm mbajtjen e z. Veliaj në kabinën/kafazin e xhamit. Nuk mjafton referimi te praktika e gjykatave të posaçme, te infrastruktura e sallës apo te konsiderata të përgjithshme sigurie. Standardi kërkon individualizim: cili ishte rreziku konkret, mbi çfarë fakti mbështetej, pse nuk mund të neutralizohet me masa më pak kufizuese dhe si u garantua që kjo mënyrë pjesëmarrjeje të mos cenonte dinjitetin, prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjen efektive. Në mungesë të një arsytimi të tillë nga gjykatat e zakonshme, qëndrimi në kafaz xhami duhet të konsiderohet cenim i dinjitetit të personit dhe i garancive themelore të procesit të rregullt.

Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë ka përpara të gjithë elementet e nevojshme për të dhënë zgjidhje përfundimtare. Ajo nuk ka nevojë të kthejë çështjen për një verifikim të ri faktik, sepse pyetjet që duhet të marrin përgjigje janë pyetje të ligjit dhe të standardit kushtetues: a është masa “arrest në burg”, e caktuar pa afat, e domosdoshme dhe proporcionale; a janë shqyrtuar realisht masat alternative; a janë individualizuar rreziqet; a është peshuar pasoja mbi mandatin e zgjedhur; dhe a është justifikuar në mënyrë konkrete izolimi në kafaz xhami. Këto janë pikërisht çështjet që Gjykata Kushtetuese kërkoi të shqyrtohen realisht, jo formalisht.

Prandaj, në zbatim të nenit 441, germa dh), të KPP-së, Gjykata e Lartë duhet të ndryshojë vendimet e gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe ta zgjidhë përfundimisht çështjen. Në përfundim të këtij shqyrtimi, ajo duhet të konstatojë se masa e sigurimit “arrest në burg”, në kushtet konkrete të çështjes, është joproporcionale, sepse nuk mbështetet në arsyetim konkret, aktual dhe të individualizuar, nuk shpjegon pamjaftueshmërinë e masave alternative dhe prodhon pasoja të rënda mbi lirinë personale dhe mandatin e zgjedhur. Po kështu, Gjykata e Lartë duhet të konstatojë se mbajtja e z. Veliaj në kabinën/kafazin e xhamit, pa bazë konkrete dhe pa arsyetim individual, cenon dinjitetin e personit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për mbrojtje efektive.

IV. Kërkesa

Për sa më sipër, kërkojmë nga Gjykata e Lartë:

1. Të administrojë parashtrimet e bashkëlidhura si pjesë të materialit të rishqyrtimit të çështjes pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
2. Të shqyrtojë çështjen me përparësi, për shkak të natyrës së saj, vijimit të kufizimit të lirisë personale, pasojës së drejtpërdrejtë mbi mandatin qershor 2023 - qershor 2027 dhe rrezikut që vonesa ta bëjë rigjykimin joefektiv.
3. Të zbatojë nenin 441, germa dh), të Kodit të Procedurës Penale dhe, pa e kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatat më të ulëta, të ndryshojë vendimet e gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, duke e zgjedhur përfundimisht çështjen në pjesën që lidhet me masën e sigurimit, për sa kohë zbatimi i ligjit procedural dhe material nuk kërkon rivlerësim faktesh apo provash.
4. Në përfundim, të vendosë në përputhje me standardin kushtetues dhe konventor për lirinë personale, proporcionalitetin, shqyrtimin real të masave alternative dhe mbrojtjen efektive të mandatit të zgjedhur.

Bashkëlidhur: Parashtrime për rishqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Me respekt,

Erion VELIAJ

Përfaqësuar nga

Av. Plarent NDRECA